

---

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“SARFED” sh.p.k.**

Sot, më datë 13. 2.2019, në Tiranë, Shqipëri, personat e mëposhtëm:

- **Z.MICHELE MARIA VALENTI**, shtetas Italian, i biri i Marco, lindur me 16.05.1987 ne Bagno a Ripoli (Fi), Itali dhe banues ne Empoli, Itali, mbajtës i letërnjoftimit italian nr. AY5714246, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
  - **Z. ANDREA CIARDELLI**, i biri i Roberto, lindur me 19.01.1990 ne Pontedera (Pi) dhe banues ne Ponsacco, Itali, mbajtës i pasaportes me nr. YA8238560, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;
- vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

**Neni 1**

**Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është “**SARFED**” Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2**


**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Sami Frasher, Nd.11, H.28, Ap.7, Njesia Bashkiake nr.5, Tirane.
- 2.2 Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

**Neni 3**

**Objekti**

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:  
Shit-blerje e kuotave dhe/ose aksioneve te kompanive të tjera.  
Pjesëmarrje direkte dhe/ose indirekte në aktivitetet tregtare.



Konsulence ligjore, financiare, tregtare, menaxhim per pale te treta dhe shoqeri te investuara, pjesëmarrëse, bashkëpunëtorë dhe ose të lidhur në përgjithësi.

Aktivitet ndërmjetësimi biznesi, bankare dhe/ose financiare ne përgjithësi, si dhe investime në emër të palëve të treta.

Rregjistrim ne mirebesim te kuotave dhe/ose aksioneve si dhe menaxhimin e tyre apo edhe në emër të palëve të treta.

#### Neni 4

##### Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.


#### Neni 5

##### Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1.000.000 Eur (nje milion).
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm, i ndare ne 2 (dy) kuota:
- **Z.MICHELE MARIA VALENTI**, shtetas Italian, i biri i Marco, lindur me 16.05.1987 ne Bagno a Ripoli (Fi), Itali dhe banues ne Empoli, Itali, mbajtës i letërnjoftimit italian nr. AY5714246, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke përfaqësuar 70 % (shtatedhjete perqind) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;
  - **Z.ANDREA CIARDELLI**, i biri i Roberto-s, lindur me 19.01.1990 ne Pontedera (Pi) dhe banues ne Ponsacco, Itali, mbajtës i pasaportes me nr. YA8238560, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke përfaqësuar 30 % (tridhjete) të kapitalit themeltar me të drejtë vote;
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

#### Neni 6

##### Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.
- 

**Neni 7**  
**Administratori**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.2 Administratoret e shoqërisë jane:
- **Z.MICHELE MARIA VALENTI**, shtetas Italian, i biri i Marco, lindur me 16.05.1987 ne Bagno a Ripoli (Fi), Itali dhe banues ne Empoli, Itali, mbajtës i letërnjoftimit italian nr. AY5714246
  - **Z.ANDREA CIARDELLI**, i biri i Roberto-s, lindur me 19.01.1990 ne Pontedera (Pi) dhe banues ne Ponsacco, Itali, mbajtës i pasaportes me nr. YA8238560, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar
- 7.3 Mandatet i Administratoreve janë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblessë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratoret, te dy sebashku apo vecmas njeri-tjetri. Administratoret jane përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

**Neni 8**  
**Viti Financiar**


- 8.1 Viti finansiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përashtimisht, viti i parë finansiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2019.

**Neni 9**  
**Të ndryshme**

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane, me të njëjtën vlerë secila.

**ORTAKËT**

**Z.MICHELE MARIA VALENTI**

Michele Maria Valent  


**Z.ANDREA CIARDELLI**

ANDREA CIARDELLI  
